



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më  
3.6.2015, e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

**Munguan:** Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

**Morën pjesë edhe:** Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit, i cili e propozoi këtë

### REND DITE:

#### 1. Rishikimi i buxhetit për vitin 2015.

##### **Pika e parë**

##### **Rishikimi i buxhetit për vitin 2015.**

**Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës, i njoftoi të pranishmit lidhur me rishikimin e buxhetit. Ai tha se në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe të Ligjit për menaxhimin e financave publike, kemi pranuar një shkresë për rishikimin e buxhetit. Këtë rishikim e kemi analizuar me Drejtorinë e Financave dhe Pronës dhe me Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

**Visar Berish**, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, tha se buxheti i propozuar për riorientim është 3,549,000 €. Këto janë marrë nga programet e disa drejtorive dhe janë orientuar në drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve kapitale publike.

**Hysen Durmishi**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se janë dy linja buxhetore që lëvizin, rruga mbi lumin Mat, që për shkak të kolektorit është ndryshuar projekti, dhe 300.000 € të tjera janë hequr nga projekti i rrugës të rrethrotullimi në lagjen "Lakërishta" deri në lagjen "Arbëria".

**Sami Hamiti** tha se ky material që na është prezantuar, si dokument është i punuar mirë, mirëpo do të ishte mirë që disa mjete të mos orientohen për projektet në zonat rurale. Ai propozoi që mjetet për projektet kapitale të ndahen në mënyrë proporcionale. Sa i përket shpronësimeve, duhet të shikohet mundësia për kompensim (këmbim) të tokës.

**Lirak Çelaj** theksoi se ka shumë projekte që nuk janë realizuar dhe ato mjete tani duhet të barten. Lidhur me rishikimin e buxhetit, ai bëri vërejtje në disa pozicione buxhetore, si në pikën një (1), nën-pikat dy (2) dhe katër (4), si dhe pikat tetë (8) dhe nëntë (9). Njëherësh kërkoi të dijë se për çfarë arsye janë hequr mjetet nga projekti për ndërtimin e teatrit të qytetit dhe nga objektet e trashëgimisë kulturore. Ai shprehu mendimin se ndërtimit të shkollave në lagjet "Veterniku" dhe "Mati", është dashtë t'u jepet më shumë prioritet për realizimin e atyre projekteve. Do të duhej të bëhej një listë e prioriteteve të projekteve kapitale, si në infrastrukturën rurale, ashtu edhe në atë urbane.

**Islam Pacolli** kërkoi që për zonat rurale të mos zvogëlohen investimet për projektet kapitale. Po ashtu ceku se në fshatin Hajvali është më se e domosdoshme të bëhen investime në infrastrukturë, sidomos në rregullimin e rrugëve dhe kanalizimit.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth rishikimit të buxhetit, **Visar Berisha** dha sqarime të nevojshme.

*Mbledhja përfundoi në orën 16:20.*

**Procesmbajtës:**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**